



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KESHILLI I ARIJUR MBIKËQYRES PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
VISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Primalo Received/Delivery	05-05-2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHOCK	2210/2021		1/7



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A. Nr. 245/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari- kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë si dhe Rushit Kajtazi- Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit duke u bazuar në Aktgjykimin me numër A. Nr.2214/2019 të datës 23.03.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.454/2019 të datës 09.08.2019 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi rruga “Agim Çela” Kalabri Emshir nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Ministria e Infrastrukturës, në çështjen juridike “ndërprerje e marrëdhënies së punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregullorës Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 05.05.2021, mori këtë

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.Nr.454/2019 e datës 09.08.2019 e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër protokolli 7477 i datës 12.07.2019 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave si dhe Vendimi me numër protokolli 5308 i datës 17.05.2019 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës.

III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e marrjes së këtij vendimi që ankuesin ta kthejë në vendin e punës në pozitën „Drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil” në Ministrinë e Infrastrukturës sipas Akt Emërimit të datës 04.07.2014 me të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës si dhe t’i bëhet kompensimi i të gjitha pagave deri në zbatimin e këtij Vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ankuesit sipas Akt emërimit të datës 04.07.2014 është i sistemuar në vendin e punës „Drejtor i Departamentit të Aviacionit Civil“ në Ministrinë e Infrastrukturës, me datë 21.12.2018 U.D Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës nxjerr vendimin me numër 11940, për pezullimin e ankuesit nga puna me 50% të pagës, me arsyetimin se ankuesi nuk ka bashkëpunuar dhe e ka ofenduar Drejtorin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 21.12.2018 me numër 11940 të U.D Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, ka parashtruar ankesë me datë 24.12.2018 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Ministrisë së Infrastrukturës me datë 23.01.2019 nxjerr Vendim me numër protokollit 657, me të cilën e Aprovon si të bazuar ankesën e ankuesit të datës 24.12.2018.

Ankuesi me datë 25.01.2019 dhe me datë 01.02.2021 parashtron kërkesë tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës, për kthim në vendin e punës, gjegjësisht zbatimin e Vendimit të datës 23.01.2019 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës.

Ankuesi me datë 20.02.2019 kundër mos zbatimit të Vendimit me numër protokollit 657 të datës 23.01.2019 të Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit të datës 20.02.2019 sepse ka qenë jo funksional.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës më datë 22.02.2019 përmes e-mailit zyrtar, parashtron kërkesë për revokim të vendimit me numër protokollit 657 të datës 23.01.2019 të Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës.

Me datë 13.03.2019 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës nxjerr vendim me numër protokollit 2616, me të cilin e aprovon kërkesën e Sekretarit të Përgjithshëm, duke e shfuqizuar vendimin me numër protokollit 657 të datës 23.01.2019 si dhe duke e lënë në fuqi vendimin e U.D Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës me numër 11940, për pezullim nga puna me 50% të pagës ndaj ankuesit

Zymer në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm me datë 26.12.2018 i ka dërguar e-mail zyrtar Udhëheqëses së Personelit ku ka theksuar se „me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, të iniciohet procedura disiplinore ndaj z.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës, me datë 17.05.2019 nxjerr Vendim Nr. 5308, me të cilin vendim ankuesit i shqipton masë disiplinore: “Ndërprerjeje e marrëdhënies së punës”.

Ankuesi më datë 14.06.2019 parashtron ankesë me numër protokoli 6433 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës, me pretendim ankimor për kthim në vendin e punës dhe shfuqizimin e Vendimit me numër protokoli 5308 të datës 17.05.2019 të Komisioni Disiplinor.

Me datë 12.07.2019 Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës, nxjerr vendim me numër protokoli 7477, me të cilin e refuzon ankesën e ankuesit dhe e lenë në fuqi Vendimin e Komisionit Disiplinor me numër 5308 të datës 17.05.2019.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoli 7477 të datës 12.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës, me datë 09.08.2019 parashtron ankesë me numër protokoli 3489 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore për kthim në vendin e punës dhe shfuqizimin e vendimit me numër protokoli 7477 të datës 12.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave dhe Vendimit me numër protokoli 5308 të datës 17.05.2019 të Komisioni Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ankesën e ankuesit me datë 13.08.2019 e ka proceduar tek Ministria e Infrastrukturës, ndërsa me datë 09.09.2019 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministria e Infrastrukturës me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/118.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 03.09.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 29.03.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2214/19 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 03.09.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 09.08.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 454/2019, e datës 09.08.2019, me numër protokoli 3489/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Aktgjykimi me numër A. Nr. 2214/2019, i datës 23.03.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, i pranuar me datë 01.04.2021; Ankesë e datës 14.06.2019, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 17.05.2019, i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 21.12.2018, për pezullimin parandalues; Vendimi i datës 13.03.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesë e datës 21.03.2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për

Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesë e datës 24.12.2018, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 12.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 23.01.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Kërkesë e datës 25.01.2019; Ankesë e datës 20.02.2019 drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Arsyetimi i datës 11.07.2019, i anëtares së Komisionet për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; E-mili zyrtar i SP te MI-se i datës 22.02.2019, ku ka kërkuar revokimin e Vendimit të KZAK-se; E-mali i datës 29.11.2018; emali i datës 30.11.2018; Vendimi i datës 12.02.2019; vendimi i datës 04.01.2019; Akt Emërimi i datës 04.07.2014; Përshkrimi i detyrave të punës; emali i datës 16.01.2019; Formuari për Vlerësimin e rezultuarve në punë; Raporti i Auditimit i datës 29.11.2018; Vendimi i datës 12.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Opinionin zyrtar të datës 06.07.2020 të ofruar nga Agjencia Kundër Korrupsionit Përgjigjja në ankesë e datës 09.09.2019, me shkresat e bashkangjitura;

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat në dosjen e lëndës ka konstatuar se Zymer Avdullahu, Zyrtar në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm me datë 26.12.2018 i ka dërguar e-mail zyrtar Udhëheqëses së Personelit ku ka theksuar se „me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, të iniciohet procedura disiplinore ndaj z. Avdi Kamerollit“

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se iniciuesi i procedurës disiplinore Zymer Avdullahu, Zyrtar në Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës, nuk është epror i drejtpërdrejtë i ankuesit e as Zyrtar kryesor administrativ në Ministrinë e Infrastrukturës, dhe duke qenë kështu, ai nuk ka qenë autoritet kompetent për të iniciuar procedurën disiplinore ndaj ankuesit. Me këtë rast është vërtetuar se inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, sepse inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankuesit është dashur të bëhet nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ose nga udhëheqësi me i lartë administrativ i organit të punësimit, gjegjësisht në këtë rast nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës ashtu siç përcaktohet në nenin 11 paragrafin 5 të Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *“Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ose udhëheqësi më i lartë administrativ identifikon detajet e shkeljes dhe vendos se shkelja disiplinore është e natyrës së parëndësishme, shkelje e lehtë apo e rëndë-serioze”*.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar që me rastin e inicimit të procedurës disiplinore përmes e-mailit zyrtar të datës 26.12.2018, është vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që përcaktojnë procedurën disiplinore dhe masat disiplinore për nëpunësit civil sepse me dispozitat e Rregullores Nr. 04/2011 për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil nenit 11 paragrafin 5 dhe nenit 12 paragrafin 1 dhe 2 janë përcaktuar kompetencat e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë apo Udhëheqësit me të lartë administrativ të institucionit si në vijim *“Udhëheqësi i drejtpërdrejtë ose udhëheqësi më i lartë administrativ identifikon detajet e shkeljes dhe vendos se shkelja disiplinore është e natyrës së parëndësishme, shkelje e lehtë apo e rëndë-serioze”* si dhe *„ Nëse Udhëheqësi i drejtpërdrejtë konstaton se shkelja mund të cilësohet si shkelje e rëndë-serioze ,*

ne afat prej dy (2) dite pune do ta paraqes rastin me shkrim te Udhëheqësi i Njësisë se personelit'' ,, Pas marrjes së njoftimit, Udhëheqësi i Njësisë së personelit, shkeljen e dyshuar ia kalon për shqyrtim komisionit disiplinor të institucionit përkatës'', sepse ne rastin konkret në kërkesën për inicimin e procedurës disiplinore, nuk është identifikuar dhe konstatuar se për cilat shkelje të parimeve dhe rregullave të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovë është përgjegjës nëpunësi civil, gjegjësisht cilat janë veprimet apo mosveprimet e ankuesit gjate kryerjes se detyrës zyrtare të cilat janë cilësuar si shkelje e rëndë-serioze, dhe me cilat dispozita janë përcaktuar ato shkelje.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave po ashtu ka shqyrtuar edhe pretendimin e ankuesit lidhur me ekzistimin e konfliktit të interesit me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore gjegjësisht me caktimin e z. Ismail Berisha si anëtar i Komisionit Disiplinor, respektivisht ankuesi pretendon se z. Berisha ka qenë vartësi i tij në kohën sa ka qenë Drejtor i Departamentit , ndërsa pas pezullimit z. Ismaili, është caktuar U.D ne pozitën e ,,Drejtorit të Departamentit të Aviacionit Civil'' dhe se me rastin e vendimmarrjes nga Komisioni disiplinor, konkretisht me Vendimin me numër 5308, të datës 17.05.201 të Ministrisë se Infrastrukturës me të cilin i është shqiptuar masa disiplinore ,,Ndërprerjeje e marrëdhënies se punës '' , ankuesi pretendon se ekziston konflikti i mundshëm i interesit.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar dëshmitë e ofruara nga palët gjegjësisht Opinionin zyrtar të datës 06.07.2020 të ofruar nga Agjencia Kundër Korrupsionit lidhur me ekzistimin e konfliktit te interesit në Vendimin e Komisionit disiplinor me numër 5308, të datës 17.05.2019 të Ministrisë se Infrastrukturës dhe ka konstatuar se Agjencia Kundër Korrupsionit ka lëshuar opinionin me tekstin si në vijim: ,,I. Është shfaqur situata e Konfliktit të Interesit ,,rast për rast'' për Zyrtarin e larte z. Ismail Berisha, i cili ka marre pjesë në procedurën disiplinore, sipas Vendimit Nr. 01\5308, të datës 17.05.2019, përmes të cilit vendim i është shqiptuar masa disiplinore ,,Ndërprerjeje e marrëdhënies se punës z. Avdi Kamerollit. II. ,,Zyrtari i lartë z. Ismail Berisha aktualisht në pozitë Udhëheqës i Divizionit të Departamentit të Aviacionit Civil- Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, duke marrë pjesë në këtë vendimmarrje ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ne Ushtrimin e Funkcionit Publik, konkretisht me konfliktin e interesit ,,rast për rast'' dispozitat e caktuara që rregullojnë ,,Veprimet e ndaluara për zyrtarin e larte '' , si dhe shumicën e dispozitave që përcaktojnë ,, Parimet e Veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë publik''.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit si dhe pasi ka analizuar përgjigjen zyrtare respektivisht Opinionin nga Agjencia Kundër Korrupsionit, ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i qëndrueshëm sepse në rastin konkret në këtë vendimmarrje ka ekzistuar situata e konfliktit të interesit ,, rast për rast '' dhe se veprimet e z. Ismail Berisha si anëtar i Komisionit Disiplinor janë në kundërshtim me dispozitat e nenit 17 të Ligjit Nr.06/L-011 Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe nenin 5 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, gjegjësisht Zyrtari i lartcekur dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë se Infrastrukturës nuk kanë respektuar parimin për Shmangien e Konfliktit të Interesit ne procedurën e zhvilluar disiplinore konkretisht në vendimmarrjen sipas vendimit me numër 5308, të datës 17.05.2019 të Komisionit disiplinor të Ministrisë se Infrastrukturës, me

te cilin vendim i është shqiptuar masa disiplinore „Ndërprerjeje e marrëdhënies se punës“ ankuesit Avdi Kamerollit .

Kolegji për shqyrtimin e ankesave gjithashtu ka konstatuar se Komisioni disiplinor ka vepruar në kundërshtim me nenin 14, paragrafin 3, të Rregullores Nr. 04/2011, për Procedura Disiplinor në Shërbimin Civil, ku thuhet se: „faktet dhe dëshmitë për seance duhet të kompletohen sa me shpejtë që është e mundur dhe komisioni duhet të marr vendim brenda tridhjetë ditësh (30) ditëve prej lajmërimit të rastit“, andaj ne rastin konkret Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se njoftimi lidhur me paraqitjen e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore, ndaj ankuesit Avdi Kamerolli, është bërë me datën 27.12.2018, nga ana e Divizionit të Burimeve Njerëzore, ndërsa Komisioni Disiplinor, me datën 17.05.2019, me ka nxjerr vendim me numër protokollit 5308, me të cilin i ka shqiptuar masën disiplinore, „ ndërprerjeje e marrëdhënies se punës“, vendim ky i cili është në kundërshtim me afatin ligjorë prej tridhjetë ditësh (30), prej paraqitjes se rastit nga Divizioni për Burime Njerëzore i Ministrisë së Infrastrukturës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, i cili pretendon se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës më rastin e shqyrtimit të masës disiplinore „Ndërprerje e marrëdhënies së punës“, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore që janë në fuqi. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, sepse Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Infrastrukturës me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 5308, të datës 17.05.2019 nuk ka arritur që të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe ligjore, gjegjësisht ka dështuar që të vlerësoj drejtë shqyrtimin e ligjshmërisë së iniciimit të shkeljes së supozuar disiplinore për ankuesin, nga Zyrtari i Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka shqyrtuar Vendimin me numër protokollit 7477 të datës 12.07.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës, dhe ka konstatuar se ky Komision nuk ka arritur që të konstatoj drejtë gjendjen faktike dhe ligjore, sepse ka lenë në fuqi vendimin e Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Infrastrukturës, me numër protokollit 5308 të datës 17.05.2019, i cili vendim është nxjerrë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Me këtë rast, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se Vendimi me numër 7477 i datës 12.07.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Ministrisë së Infrastrukturës, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

*Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda Nr. A. Nr. 245/2021*


Malsore Gashi – BAJRAKTARI
Kryetare e Kolegjit

Rushit KAJTAZI
Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit Avdi Kamerolli;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Infrastrukturës
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Infrastrukturës;
- Arkivit të KPMSHCK-së